



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA E LIPJANIT  
REPUBLIC OF KOSOVA

Pranuar me: Primitje:	03.09.2024	
Njesia Jednica	Numri Brez	Shtojca Dodatak
15-052/01	44197	



REPUBLIKA KOSOVA  
OPSTINA LIPJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORATI PËR PLANIFIKIM, URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Datë:	03.09.2024
Referencë:	ZR
Për:	Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit të Komunës
Nga:	Imri Semetishti, Drejtor i DPUMM
Kopje:	Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
Lënda:	Raporti Monitorues për Zbatimin e Hartes Zonale të Komunës së Lipjanit për periudhen 03.07.2023 – 03.07.2024



Përmes këtij akti ju dërgojmë Raportin Monitorues për Zbatimin e Hartes Zonale të Komunës së Lipjanit për periudhen 03.07.2023 – 03.07.2024 për shqyrtim dhe miratim në seancën e radhës të Kuvendit të Komunës.

Shtojcë:

Raporti Monitorues për Zbatimin e Hartes Zonale të Komunës së Lipjanit për periudhen 03.07.2023 – 03.07.2024.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

---

**RAPORT MONITORUES  
PËR ZBATIMIN E HARTËS ZONALE TË KOMUNËS SË LIPJANIT PËR  
PERIUDHEN 3 KORRIK 2023 - 3 KORRIK 2024**

Gusht 2024

## Përmbajtja:

I. TË PËRGJITHSHME.....	3
1. Hyrje .....	3
2. Përmbledhje e e HZK-së.....	3
3. Përmbledhje ekzekutive.....	4
4. Qëllimi i raportit mbi vlerësimin e zbatimit të HZK.....	5
5. Procesi dhe metodologjia e punës.....	5
6. Korniza e monitorimit të zbatimit të HZK.....	6
II. MONITORIMI I ZBATIMIT TË HZK SIPAS FUSHAVE SEKTORIALE.....	6
7. Analiza dhe rezultatet e vlerësimit të zbatimit të HZK.....	6
8. Numri i lejeve ndërtimore dhe i certifikatave të përdorimit.....	7
9. Vlerësimi i përgjithshëm i efekteve bazuar në monitorimin e zbatimit të HZK në aspektin urban.....	8
10. Gjendja mjedisore .....	9
11. Shkalla e ngritjes së cilësisë së shërbimeve publike dhe sociale .....	12
12. Shkalla e ngritjes së cilësisë së shërbimeve transportuese dhe teknike.....	12
13. Përqindja e realizimit të investimeve kapitale publike dhe publiko private të realizuara në periudhën e caktuar në kuadër të infrastrukturës dhe shërbimeve publike.....	13
14. Shkalla e investimeve të mëdha të planifikuara .....	14
15. Trafiku rrugor dhe projektet e realizuara në infrastrukturë.....	14
16. Projektet e realizuara në kuadër të shëndetësisë dhe mirëqenies sociale.....	15
17. Projektet e realizuara në kuadër të Arsimit.....	16
18. Projektet e realizuara në kuadër të Zhvillimit Ekonomik.....	17
19. Shkalla e prodhimitarisë.....	17
20. Anketimet e familjeve bujqësore.....	18
21. Vlerësimi i përgjithshëm për të arriturat sipas fushave sektoriale.....	19
III. PËRFUNDIMTARE .....	20
22. Rishqyrtime i përmbajtjes dhe përmasave të ndryshim plotësimeve, përjashtimeve dhe bonuseve të zonimit.....	20
23. Përfundim.....	20



## **I. TË PËRGJITHSHME**

### **1. HYRJE**

Në mbështetje të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Autoriteti komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor, në këtë rast Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit (DPUMM) është përgjegjës për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartës Zonale të Komunës.

Kuvendi i Komunës së Lipjanit ka miratuar Hartën Zonale të Komunës (HZK) 2021 -2029 me Vendimin Nr.15-030-30033 të datës 04.06.2021.

Hartimi i Raportit për monitorimin e zbatimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor vie si kërkesë e nenit 10 paragrafi 3 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor, përkatësisht nenit 42 dhe 43 të Udhëzimit Administrativ Nr.24/2015 mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Hartës Zonale të Komunës.

Ky Raport për monitorimin e zbatimit të HZK-së përfshinë periudhën një vjeçare nga data 3 korrik 2023 deri me 3 korrik 2024<sup>1</sup>.

Sipas nenit 42 dhe 43 të Udhëzimit Administrativ Nr.24/2015 mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Hartës Zonale të Komunës, DPUMM është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të HZK-së në koordinim dhe bashkëpunim me drejtoritë përgjegjëse sektoriale. Ndërlidhur me këte, përveç DPUMM edhe drejtoritë tjera sektoriale kanë përgatitur të dhënat për zbatimin e planeve zhvillimore sipas fushave të caktuara të cilat janë përfshirë në këtë Raport.

### **2. PËRMBLEDHJE E HZK-së**

Harta Zonale e Komunës është një dokument multi-sektorial që përmes grafikoneve, fotografive, hartave dhe tekstit përcakton hollësisht llojin, destinimin, shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës dhe masat e veprimit të cilat bazohen në kohëzgjatje dhe projeksione të arritshme të investimeve publike dhe private për tërë territorin e Komunës, për një periudhë së paku tetë (8) vjeçare.

Qëllimi i HZK-së është ruajtja e pasurisë dhe mirëqenies publike duke kontrolluar vendndodhjen, vëllimin dhe shfrytëzimin e të gjitha parcelave, ndërtesave dhe strukturave, nëpërmjet zhvillimit të qëndrueshëm të tokës brenda territorit të komunës. Po ashtu, HZK përcakton planifikimin hapësinor dhe kushtet për zhvillim urban në kuadër të pronave private, si dhe ofron informata për qytetarët, se si mund t'i shfrytëzojnë dhe zhvillojnë pronat e tyre.

HZK konsiderohet si mjet për të zbatuar PZHK-në dhe si dokument i tillë shërben edhe për të mbrojtur komunën nga ndikimet negative në mjedis, përkatësisht nga zhvillimet e pa planifikuara. Për më shumë, HZK shërben si mjet për të promovuar zhvillimin ekonomik dhe social përgjatë

<sup>1</sup> Për periudhën e kaluar një vjeçare 03.07.2022- 03.07.2023 kemi kemi raportuar në vitin e kaluar.



gjithë territorit të komunës. Kjo do të thotë që HZK është mjet për të orientuar dhe ndihmuar zhvillimet dhe për të promovuar qëndrueshmërinë socioekonomike të tyre.

HZK ofron elaboratin e hollësishëm të kufinjve të zonave dhe kushteve zhvillimore për secilën zonë brënda Komunës së Lipjanit. Definimi i zonave është bërë me hartën e shfrytëzimit të tokës, me të cilën janë përcaktuar tërësitë hapësinore dhe shfrytëzimet e tyre. Kjo është bërë në bazë të PZHK-së 2013-2023.

Emërtimi i zonave është bërë në përputhje me Udhëzimin Administrativ për normat teknike të planifikimit hapësinor. Në caktimin e zonave është aplikuar parimi i sigurimit të zhvillimit të planifikuar - bazuar në gjendjen faktike.

Harmonizimi i kërkesave të interesit publik me të drejtat në pronën private, promovimi i shëndetit dhe sigurisë publike si dhe kapacitetet e planifikuara të shërbimeve dhe ndërtesave publike e private janë marrë në konsideratë sidomos në përcaktimin e zonës së banimit dhe zonës së shërbimeve.

Zonat me vlera natyrore, trashëgimisë kulturore dhe zona e interesit të veçantë<sup>2</sup>, si dhe sipërfaqet ujore janë bazuar në parimin e sigurimit të mbrojtjes së karakterit natyror, historik, kulturor dhe peisazhor, si dhe kriterëve që dalin nga vendimet dhe ligjet e fushave të veçanta.

### 3. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Rezultatet e arritura gjatë periudhës raportuese dhe që kanë implikime hapësinore sipas HZK mund të përmbliidhen në faktet më të rëndësishme si:

- Shqyrtimi i shumicës së kërkesave të parashtruara në fushën e ndërtimit, përfshirë ato për kushte dhe leje ndërtimi. Në kuadër të kërkesave për kushte ndërtimi, janë miratuar rreth 59.39% prej tyre, kurse për leje ndërtimi janë miratuar rreth 62.06%<sup>3</sup> të kërkesave të shqyrtuara.

- Kërkesat për certifikatë përdorimi – nga 9 të parashtruara, prej tyre 7 janë shqyrtuar.

- Kërkesat për trajtimin e ndërtesave pa leje janë shqyrtuar në nivelin e duhur dhe përfundimisht ky proces është duke u menaxhuar me sukses.

- Projektet në infrastrukturë publike janë realizuar dhe gjenden në realizim e sipër sipas Planit të Veprimit të përcaktuar me HZK dhe me planifikimin buxhetor për vitin 2023 dhe 2024. Megjithatë, realizimi i disa projekteve ka hasur në vështirësi për shkak të shkëputjes së kontratave si rezultat i mos respektimit të kontratave dhe pengesave të tjera administrative, përkatësisht i mos përgjigjeve me kohë në ankesat e parashtruara nga pjesëmarrësit në aktivitetet e prokurimit.

- Projektet tjera sipas fushave sektoriale dhe të cilat nuk kanë pasur implikime hapësinore janë realizuar në nivelin e planifikimeve vjetore.

<sup>2</sup> Zona në Kleçkë dhe Divjakë – SHP i UÇK-së.

<sup>3</sup> Në kuadër të lejeve të miratuara është edhe një numër i caktuar që janë dhënë për objektet e infrastrukturës publike dhe disa leje për restaurimin e shtëpive në Janjevë sipas kërkesës së UNDP-së, për të cilat kriteret e përcaktuara me HZK nuk kanë qenë të aplikueshme.



Përgjithësisht, nëse i referohemi të dhënave statistikore, vlerësohet se zbatimi i HZK-së është në nivel të arsyeshëm. Megjithatë vlerësojmë se gjendja reale mund të jetë pak më ndryshe për shkak se shumë palë të interesuara nuk kanë aplikuar për ndërtim pasi që paraprakisht janë njoftuar me kushtet e përcaktuara me HZK dhe në disa raste me pamundësinë e ndërtimeve në pronat e tyre.

DPUMM për të gjitha lejet ndërtimore të lëshuara respekton destinimin e zonave, pastaj kujdeset që të krijoj siguri për banorët, të siguroj cilësi të jetesës sipas normave urbane dhe aplikon të gjitha kërkesat për mbrojtje të mjedisit.

#### **4. QËLLIMI I RAPORTIT PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË HZK**

Qëllimi kryesor i këtij Raporti është të ofroj informacione themelore për shkallën e zbatimit të qëllimeve dhe objektivave të deklarura me HZK dhe të ofrojë rekomandimet e duhura të cilat janë të nevojshme për zbatimin e HZK-së, si dhe për vazhdimin e procesit të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal.

Përmes monitorimit për zbatimin e HZK-së, do të ofrohet një reflektim lidhur me zhvillimin e komunës pas realizimit të aktiviteteve të planifikuara, për gjendjen aktuale në hapësirë, si dhe për rezultatet e arritura. Mbi të gjitha, një pjesë e projekteve të realizuara kanë ndikim (implikim) të drejtpërdrejtë hapësinor, sidomos ato në fushën e ndërtimit të ndërtesave banesore dhe afariste si dhe projektet e realizuara në kuadër të infrastrukturës publike.

Raporti ofron po ashtu edhe teknikat/veçat dhe metodologjinë e përdorur, të cilat janë zhvilluar për vlerësimin e planit.

#### **5. PROCESI DHE METODOLOGJIA E PUNËS**

Raporti është hartuar nga DPUMM në bashkëpunim me Drejtoratet komunale që mbulojnë fushat e caktuara sektoriale. Për të realizuar këtë proces të monitorimit, DPUMM ka zhvilluar mjete dhe metodologji pune të cilat mund të shfrytëzohen dhe avancohen si mjete pune për ndërtimin e një sistemi të monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm për zbatimin e planeve edhe në të ardhmen.

Mjetet e zhvilluara gjatë këtij procesi janë bazuar në llojin dhe strukturën e HZK dhe përfshijnë:

- Kornizën për monitorimin e zbatimit të aktiviteteve të përcaktuara me planet e veprimit në kuadër të drejtorateve sektoriale në relacion me HZK-në;
- Analizen e procesit të shqyrtimit të kushteve ndërtimore sipas kërkesave dhe sfidat gjatë trajtimit të tyre në raport me kushtet e përcaktuara në HZK;
- Vlerësimin e efekteve që kanë rezultuar nga zbatimi i atyre projekteve;
- Aplikimi rigoroz i lejeve mjedisore komunale; dhe
- Krahasimi i ndarjeve buxhetore dhe nivelit të realizimit të projekteve,

Metodat e aplikuara në përpilimin e Raportit monitorues të zbatimit të qëllimeve dhe objektivave të deklaruar me HZK janë të ndryshme dhe mbi të gjitha ato ndërlidhen me bashkëpunimin me Drejtoratet komunale sektoriale nga të cilët janë siguruar informacione të rëndësishme për monitorimin e zbatimit të HZK përmes realizimit të planeve/ projekteve të cilat janë prezentuar në pjesën tabelare të këtij Raporti.



## 6. KORNIZA E MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË HZK

Monitorimi i zbatimit të HZK bazohet në të arriturat zhvillimore të komunës. Procedura e monitorimit paraqet një mjet për konfirmimin e arritjeve në relacion me projektet e planifikuara dhe rezultateve të pritura. Kjo përgjigje nuk mund të jetë e drejtpërdrejt dhe e prerë saktësisht brenda një periudhe të caktuar, meqenëse zbatimi i planeve është një proces i ndërlikuar që lidhet me një sërë veprimesh të kushtëzuara dhe që administrativisht procedohen dhe pastaj zhvillohen në kohë relativisht të gjatë.

Për më shumë periudha kohore për monitorimin e zbatimit të HZK që përfshinë gjysmen e perudhave të dy viteve (3 korrik 2023 – 3 korrik 2024) e bënë edhe më të ndërlikuar këtë proces për shkak të:

- planifikimit dhe miratimit të buxhetit për një vit fiskal; dhe
- realizimit të disa projekteve brenda një viti fiskal dhe të tjerave për më shumë se një vit fiskal.

Vlerësimi i monitorimit të zbatimit të HZK-së përfshinë aplikueshmërinë e normave dhe vlerave urbane teknike në trajtimin e kërkesave në fushën e ndërtimeve dhe shfrytëzimin e hapësirës në Zonën e banimit<sup>4</sup> dhe Zonën mbishtresore<sup>5</sup>. Mbi këtë bazë, vlerësimi i monitorimit të HZK është bërë duke pasur parasysh planet e veprimit të fushave sektoriale dhe nivelin e realizimit të tyre në rrjedhshmëri me Planin e Veprimit<sup>6</sup> sipas Shtojcës 1 të përcaktuar me HZK.

## II. MONITORIMI I ZBATIMIT TË HZK SIPAS FUSHAVE SEKTORIALE

### 7. ANALIZA DHE REZULTATET E MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË HZK

Në kuadër të zonave të përcaktuara në HZK janë përfshirë një sërë veprimesh për çdo fushë sektoriale. Veprimet janë të përkufizuara në aspektin e kohëzgjatjes kohore në periudhën e caktuar të vitit 2023 dhe 2024, implikimeve financiare dhe aty ku veprimet ishin të ndërlidhura edhe me periudhën kohore për zbatim sipas kornizës afatmesme të buxhetit 2023-2026.

Është bërë identifikimi i veprimeve që janë realizuar dhe atyre më themelore (synimeve) që planifikohen të përfshihen në planet e ardhshme. Zbatimi i aktiviteteve/projekteve të propozuara ka shërbyer për vlerësimin e efekteve (nivelin) në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, social dhe hapësinor të komunës.

Monitorimi është bërë për çdo fushë sektoriale dhe në bazë të vlerësimit vetanak nga ana e zyrtarëve përgjegjës të Komunës lidhur me të arriturat në sektorët e tyre.

<sup>4</sup> Në Zonën e banimit përfshihen: nënzonat banimore për tërë territorin e Komunës së Lipjanit, zona industriale, komerciale, bujqësore, pyjore dhe zona rekreative turistike.

<sup>5</sup> Në Zonën mbishtresore përfshihen: zona e mbrojtur e aeroportit, zona e interesit të veçantë, zona mbishtresore seizmike, zona e ndikuar nga vërshimet, zona me ndotje të lartë, zona e mbrojtur e trashëgimisë kulturore dhe zona e mbrojtur e trashëgimisë natyrore.

<sup>6</sup> Në Shtojcën 1 të HZK (faqe 167) janë paraqitur të gjitha projektet dhe aktivitetet e planifikuara sipas fushave sektoriale.



## 8. ZBATIMI I HZK-së NË ASPEKTIN URBAN PËR PERIUDHËN 3 KORRIK 2023 – 3 KORRIK 2024.

### 8.1. Kërkesat për kushte ndërtimore:

Kërkesat për kushte ndërtimore paraqesin një nga aktivitetet themelore që zhvillohen në fushën e urbanizmit, njëkohësisht edhe çështjen më të ndërlikuar për zbatimin e kriterëve të përcaktuara me HZK në raport me kërkesat e palëve, e në raste të caktuara kjo çështje është tepër sfiduese në procesin ankimor.

Për periudhen raportuese vërehet një rritje e numrit të kërkesave të parashtruara për kushte ndërtimore krahasuar me periudhen paraprake raportuese.

Për kushte ndërtimore, në periudhen raportuese janë pranuar gjithsejtë 142<sup>7</sup> kërkesa. Prej tyre janë shqyrtuar 133 kërkesa (93.66%), ku janë miratuar gjithsejtë 79 kërkesa (59.39%), ku pjesa më e madhe e tyre janë lëshuar në zonat komerciale dhe zonat suburbane të banimit (banim i ulët).

Kërkesat tjera (50) janë refuzuar (37.59%) si rezultat i mosplotësimit të kushteve urbane – teknike të përcaktuara me HZK, dy (2) kërkesa janë pezulluar (0.15%), dy (2) janë ceduar, kurse 9 kërkesa janë në proces shqyrtimi.

### 8.2. Kërkesat për leje ndërtimore:

Në periudhen raportuese për leje ndërtimi janë pranuar 126 kërkesa<sup>8</sup>, ku brenda asaj periudhe raportuese janë shqyrtuar 116 kërkesa (92.06%). Prej kërkesave të shqyrtuara janë miratuar 72 kërkesa (62.06%), janë refuzuar 41 kërkesa (35.34%), një (1) kërkesë është e pezulluar dhe dy (2) janë të ceduara. Ndërsa 10 kërkesa të tjera janë në proces të shqyrtimit. Parashtrimi i kërkesave për leje ndërtimore varet drejtpërdrejtë nga kërkesat e miratuara për kushte ndërtimore<sup>9</sup>.

Statusi i kërkesave për leje ndërtimi për gjysmë periudhat e viti 2023 dhe 2024.

Nga data 3 korrik 2023 deri me datën 31 dhjetor 2023 – kemi këtë status të kërkesave:

- Të pranuar 68 kërkesa;
- Të shqyrtuara 66 kërkesa;
- Të miratuara 44 kërkesa (25 të kategorisë së I-rë dhe 19 të kategorisë së dytë);
- Të refuzuara 22 kërkesa.
- Të bartura në vitin 2024 – 8 kërkesa<sup>10</sup>.

Nga data 1 janar 2024 deri me datën 3 korrik 2024 – kemi këtë status të kërkesave:

<sup>7</sup> Në periudhen paraprake raportuese ishin pranuar 127 kërkesa për kushte ndërtimore. Vlefshmëria e kushteve ndërtimore është një vit.

<sup>8</sup> Në periudhen paraprake raportuese ishin pranuar 110 kërkesa për leje ndërtimore.

<sup>9</sup> Fillimisht aplikohet për kushte ndërtimore. Subjekteve që iu miratohen kërkesat për kushte ndërtimi e fitojnë të drejtën për paraqitjen e kërkesës për leje ndërtimi. Me kushtet ndërtimore, përveç tjerash mund të përcaktohet ndonjë kërkesë/a për plotësim e cila jo gjithnjë arrihet nga palët. Në këto rrethana jo të gjithë ata që marrin kushtet ndërtimore aplikojnë edhe për leje ndërtimore. Prandaj numri i kërkesave për lejeve ndërtimore paraqet një tregues tejet të brishtë krahasuar me numrin e kërkesave për kushte ndërtimore.

<sup>10</sup> Disa prej këtyre kërkesave janë parashtruar në muajin dhjetor të viti 2023 dhe nuk kemi arritur të bëjmë shqyrtimin e tyre.



- Të pranuar 50 kërkesa – plus 8-kërkesa të bartura nga viti 2024;
- Të shqyrtuara 48 kërkesa nga numri i kërkesave të pranura dhe të bartura;
- Të miratuara 28 kërkesa (19 të kategorisë së I-rë dhe 9 të kategorisë së dytë);
- Të refuzuara 19 kërkesa.
- Të bartura në periudhen vijuese të vitit 2024 – 10 kërkesa.

Lidhur me Lejet Mjedisore komunale shih pikën 10.1 të këtij Raporti.

### **8.3. Çertifikatë përdorimi:**

Në periudhen raportuese janë pranuar 4 kërkesa për çertifikatë përdorimi dhe 5 të tjera kanë qenë të bartura nga periudha e kaluar. Të gjitha kërkesat kanë qenë për kategorinë e II-të ndërtimeve. Prej tyre janë miratuar 5 kërkesa, një e refuzuar dhe një e pezulluar. Në proces janë edhe dy kërkesa.

### **8.4. Legalizimet:**

Kërkesat për trajtimin e ndërtesave pa leje (procesi i legalizimit) janë trajtuar në nivel mjaft të lartë. Nga gjithsejtë 123 kërkesave në periudhen raportuese janë shqyrtuar 99 kërkesa, 35 janë miratuar, 7 janë vendosur në listen e pritjes dhe 57 janë refuzuar. Kurse në proces/shqyrtim kanë mbetur edhe 24 kërkesa.

### **8.5. Informacione/ekstrakte nga HZK:**

Për periudhen raportuese janë pranuar 91 kërkesa për informacione urbane. Për 83 kërkesa janë dhënë informacionet urbane/ ekstraktet nga HZK, 7 kërkesa janë refuzuar dhe një është në proces.

### **8.6. Çështje të tjera:**

Në kudër të çështjeve të tjera tematike nga fusha e planifikimit hapësinor dhe bazuar në HZK është bërë hartimi i projekteve të detajuara për objekte të ndryshme infrastrukturore, duke përfshirë:

- Projektet për hapjen dhe ndërtimin e rrugëve të reja;
- Projektet për ndërtimin e shkollave dhe qerdheve;
- Rregullimi dhe pastrami i shtretërve të lumenjëve/prrockave;
- Projekte të tjera të infrastrukturës publike dhe sociale.

## **9. VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I EFEKTEVE BAZUAR NË MONITORIMIN E ZBATIMIT TË HZK NË ASPEKTIN URBAN**

Vlerësojmë se në periudhen raportuese, zbatimi i HZK ka shënuar një nivel të arsyeshëm në fushen urbane, përkatësisht në fushen e ndërtimeve të ndërtesave me destinim si shtëpi të veçanta banimi, të ndërtesave me shumë mjësi banimi dhe afariste, si dhe të ndërtesave të ndryshme afariste.

Nga monitorimi i zbatimit të HZK në aspektin urban, numri i kërkesave për kushte ndërtimore dhe leje ndërtimore të lëshuara për periudhën 3 korrik 2023 – 3 korrik 2024 na jep një pasqyrë se në të gjitha këto kategori zbatueshmëria e HZK-së është në nivelin mbi 50%.



Megjithate numri i kërkesave të miratuara dhe refuzuara për kushte ndërtimore, sigurisht do të kishte një pasqyrim më ndryshe po të mos ishin informacionet urbane që iu ofrohen palëve sipas kërkesës së tyre para se të ushtrojnë kërkesë për kushte ndërtimore.

Prandaj, duhet pasur parasysh faktin se gjatë periudhës raportuese janë lëshuar një numër tejet i lartë i informacioneve urbane dhe ekstrakte nga HZK për paracela të caktuara, si dhe janë zhvilluar konsultime të shumta me qytetarë lidhur me mundësitë zhvillimore në pronat e tyre.

Edhe më tutje disa kritere urbane teknike të HZK-së po konsiderohen si më sfiduese dhe kanë ndikim të theksuar në zhvillimin e planit hapësinor urban dhe realizimin e interesave të pronarëve, përkatësisht në dhënien e lejeve ndërtimore. Kjo situatë pothuaj në masë të njëjtë është në të gjitha zonat urbane të Komunës, por në ato qendrore është më e theksuar. Kriteret e identifikuar në HZK, që konsiderohen si sfidë në zbatim janë:

- Kriteri që e definon largësinë e vijës ndërtimore nga rrugët ekzistuese dhe ato të planifikuara;
- Mospërputhjet ndërmjet koeficientit të ndërtimit, etazhitetit dhe vlerës së përcaktuar për shfrytëzimin e sipërfaqes ndërtimore; dhe
- Kriteri për përcaktimin e gjerësisë së ballit (frontit) të parcelës ndërtimore përgjatë rrugëve ekzistuese dhe atyre të planifikuara si dhe rritja shtesë në raport me madhësinë e sipërfaqes mbi minimumin e përcaktuar.

Po ashtu, për çështjet urbane teknike nuk mund të kemi një vlerësim të plotë të zbatueshmërisë së HZK pa një vlerësim specifik të nevojave dhe mundësive buxhetore për hapjen e rrugëve të reja. Hapja e rrugëve të reja në zonat të cilat dominohen me pronësi private dhe që kanë ndodhur shitblerje të shumta, është një nga sfidat themelore nga e cila çështje po rrjedhin reagime të ndryshme lidhur me zbatueshmërinë e HZK-së. Kjo problematikë duhet të merret parasysh në të ardhmen e afërme.

### ***9.1. Synimi themelor për periudhën vijuese:***

Përfundimi i hartimit të Planit Zhvillimor Komunal 2023-2031.

Megjithate përfundimi i PZHK ka hasur në vështirësi dhe aktualisht është pezulluar për shkak të mos dhënies së pëlqimit në Raportin e Vlerësimit Startegjik Mjedisor dhe kushtëzimi nga MMPHI për përfshirjen e “Deponisë sanitare regjionale” në pjesen pererendimore të kufirit me “Zonën e licencuar ekonomike” në Qylagë.

## **10. GJENDJA MJEDISORE**

Komuna e Lipjanit si edhe çdo komunë tjetër përballet me disa rreziqe mjedisore në fusha të ndryshme.

Ndër shkaktarët themelor të rrezikimit të mjedisit konsiderohen: ujërat e zeza, degradimi i pyjeve dhe niveli i lartë i dioksidit të karbonit si pasojë e veprimtarisë së disa industrive të ndryshme, lirimimi i gasrave nga qarkullimi i automjeteve, veprimtaritë e shumë gurthyesve që veprojnë afër vendbanimeve dhe vlerave të mbrojtura natyrore, vendprodhimet e asfaltit, etj.



Lidhur me trajtimin e ujërave të zeza gjatë periudhës raportuese, Komuna e Lipjanit ka përfunduar disa projekte në fushën e ndërtimit të kanalizimeve. Po ashtu në proces të zbatimit janë edhe disa projekte të ngjajshme brënda kësaj periudhe<sup>11</sup>. Por edhe mëtej mbetet shqetësuese mungesa e impiantëve për trajtimin e ujërave të zeza, të cilat projekte vlerësojmë se duhet zhvilluar në nivel kombëtar.

Komuna e Lipjanit ka marrë masa të konsiderueshme edhe në çështjet preventive të vërshimeve. Lidhur me këto janë rregulluar shtretërit e disa lumenjëve dhe kanaleve kulluese (prrockave)<sup>12</sup>. Këto masa kanë sjellur në minimum rreziqet nga vërshimet. Megjithatë rreziku më i madh nga vërshimet në Komunën e Lipjanit shkaktohen nga lumi "Sitnica". Lidhur me këto, Komuna ka planifikuar vazhdimin e rregullimit edhe të një pjese të shtratit të lumit. Megjithatë kjo çështje është ndërkomunale dhe përfundimisht zgjidhja mund të arrihet së bashku me komunat nëpër të cilat kalon ky lum apo sipas një projekti të nivelit nacional.

Lidhur me degradimin e pyjeve përgjegjësi themelore tani është jashtë autoriteteve komunale. Megjithatë, Komuna është duke e intensifikuar angazhimin në fuqizimin e kontrolleve në kuadër të përgjegjësive të saja.

Lirimin e gasrave nga industrinë dhe bizneset e ndryshme, si dhe nga qarkullimi i automjeteve – sidomos atyre të vjetra është çështje që duhet ta trajtojnë organet e nivelit qendror.

Në kuadër të mbrojtjes mjedisore, komuna ka mundur kushtet për zhvillimin e disa projekteve të energjisë efiçente në kuadër të disa ndërtesave afariste dhe po ashtu ka realizuar disa projekte në ndërtesat shkollore.

### **10.1. Ndërtimet dhe gjendja mjedisore**

Ndërtimet e ndërtesave të kategorisë së II-të janë të ndërlidhura edhe me çështjet specifike mjedisore, të cilat janë nën përgjegjësinë e autoriteteve kompetente të Komunës.

Për periudhën raportuese janë lëshuar 41 Leje Mjedisore Komunale, kurse 6 janë refuzuar. Kurse nga MMPHI kemi pranuar 13 Leje Mjedisore.

Në shqyrtimin e lëndëve për leje mjedisore trajtohen elementet themelore të ndikimeve në mjedis, si në:

- në tokë, ajër, ujë, florë dhe faunë, gjenerim të mbeturinave, zhurma, procesi teknologjik i punës, masat në raste të aksidenteve, masat për rehabilitimin e sipërfaqës gjelbëruese si dhe masat për efiçencën e energjisë, caktohet lokacioni i kontejnerëve në situacion, sipërfaqja e gjelbërt, mbjellja dhe lokacionet e drunjëve etj.

Janë zhvilluar disa aktivitete vëdiqësuese mbi faktorët e ndotjes së mjedisit natyror. Gjatë javës së Tokës, përkatësisht mbrojtjes së mjedisit kemi zhvilluar aktivitete vëdiqësuese si mbjellja e luleve në qendrën e qytetit të Lipjanit, aktivitete me fëmijët e qerdhës së qytetit, duke përfshirë vizatime nga fëmijët për çështje mjedisore si shenjë simbolike, pastaj pastrimi i disa sektorëve rrugor,


<sup>11</sup> Për më shumë shih projektet infrastrukturore në pikën 15 të këtij Raporti

<sup>12</sup> Për më shumë shih projektet infrastrukturore në pikën 15 të këtij Raporti



marrja pjesë në konferenca aktivitete me organizata vendore dhe ndërkombëtare për lidhshmërinë ekologjike në Kosovë, mbjellja e drunjëve në hapësira publike e shkolla me Eko Klubet e shkollave, shpërndarja e broshurave për vedijësimin e qytetarëve për mbrojtjen e mjedisit, etj.

Në fushën e Mjedisit po ashtu kemi bërë identifikimin në terren të deponive ilegale të mbeturinave dhe i kemi digjitalizuar në sistemin GIS që rezultojnë 77 deponi. Duke mos përfshi 11 prej tyre të cilat janë pastruar si pjesë e projekteve të komunës.



*Harta 1. Deponitë e Mbeturinave Ilegale të Pastruara*

Lokacionet e këtyre deponive të pastruara janë në: Gillogoc, Gumnasellë, Banullë, Rufe i Ri, Smallushë, Poturoc, Qylagë dhe Mirenë. Vendndodhja e tyre kryesisht shtrihet përgjatë shtretërve të lumenjëve, përroskave dhe rreth rrugëve e rrugicave.

**Lidhur me çështjet mjedisore, rendësi i kemi kushtuar edhe pjesëmarrjes në aktivitetet e organizuara nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare si:**

- Tema: “Lejet Mjedisore dhe Ujore (sfidat, praktikat dhe mundësite).
- Puntoria e organizuar nga MMPHI dhe organizata mjedisore Sllovene WWF me tematikë Lidhshmëria ekologjike në Kosovë.
- Punëtorja e Ekipit Teknik për Bashkëpunimin Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave organizuar nga GIZ dhe MMPHI me komunat.



- Takimet për Strategjinë për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Republikën e Kosovës 2024-2035 dhe Planin e Veprimit 2024-2026 organizuar nga JICA dhe AMMK me komunat.

- Mjedisi dhe efienca e energjisë.

## 11. SHKALLA E NGRITJES SË CILËSISË SË SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE SOCIALE

Cilësia e shërbimeve publike në Komunën e Lipjanit në vazhdimësi sa vie e rritet. Në këtë proces, faktor me ndikim themelor përveç investimeve të reja është mirëmbajtja e infrastrukturës së shërbimeve publike, ku përmes formës kontraktuale zbatohen aktivitetet e tilla, përveç mirëmbajtjes së rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, si dhe menaxhimit të mbeturinave, për të cilat shërbime janë përgjegjëse ndërmarrjet publike përkatëse.

Kontratrat për mirëmbajtje të infrastrukturës prezantohen në tabelen në vijim:

Tabela 1<sup>13</sup>:

Nr.	Kontratrat sipas objektit/lëndës së kontraktuar për mirëmbajtje	Statusi
1.	Mirëmbajtja e parqeve, parkingjeve dhe hapësirave të tjera publike në qytetin e Lipjanit	Në zbatim
2.	Mirëmbajtja dhe rehabilitimi i rrjeteve të kanalizimit në qytet dhe fshatra	“
3.	Mirëmbajtja e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit veror	“
4.	Mirëmbajtja e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimëror Llotet 1 deri në 5	“
5.	Hapja-pastrimi i lumenjëve dhe mirëmbajtja e hapësirave publike në fshatra	“
6.	Hapja-pastrimi i lumenjëve dhe mirëmbajtja e hapësirave publike në fshatra	“
7.	Mirëmbajtja e shenjzimit horizontal dhe vertikal dhe sinjalizimit në Komunën e Lipjanit	“
8.	Mirëmbajtja e tregjeve	“
9.	Mirëmbajtja e varrezave dhe lapidarëve	“
10.	Mirëmbajtja e ndriçimit publik	“
11.	Instalimi i Free WiFi-së	“

## 12. SHKALLA E NGRITJES TË CILËSISË SË SHËRBIMEVE TRANSPORTUESE DHE TEKNIKE

Fusha e shërbimeve të transportit në komunën e Lipjanit është e rregulluar me dispozitat ligjore ku në kuadër të kësaj e kemi miratuar Rregulloren për Transportin e Udhëtarëve me Autobus dhe Planin e Transportit Publik të udhëtarëve me autobus.

Në komunën e Lipjanit shërbimet e transportit të udhëtarëve janë të organizuara me autobus dhe kryhen nga operatorët privat. Të gjitha vendbanimet rurale të komunës janë të lidhura me qytetin

<sup>13</sup> Në Tabelen 1 janë përfshirë kontratat për mirëmbajtje që aktualisht janë në zbatim pavarësisht kohës të lidhjes së tyre.

e Lipjanit, kurse disa linja nga vendbanimet më të mëdha janë të lidhura drejtpërdrejt edhe me kryeqendrën – Prishtinën.

Sipas Planit janë të përfshira 28 linja me orare dhe vendndalje për marrje dhe zbritje të udhëtarëve. Gjithsejtë janë 194 vendndalje në qytet dhe në të gjitha fshatrat.

Në territorin e Komunës sonë operojnë 12 operatorë të transportit me autobus si dhe rreth 160 operatororë të transportit të udhëtarëve me automjete taksi, duke përfshirë qytetin e Lipjanit dhe aeroportin ndërkombëtar “Adem Jashari”.

Të gjitha vendbanimet rurale janë të lidhura me rrugë të asfaltuara me qytetin e Lipjanit dhe kjo ndikon shumë në zhvillimin e transportit pa vështirësi teknike dhe në shvillimin e lëvizjeve me shpejtësi normale.

Në përputhje me HZK, në fushën e trafikut rrugor është punuar specifikisht në sinjalistikë rrugore (shenjëzimi horizontal dhe vertikal) dhe në vendndalejn e autobusëve si në qytetin e Lipjanit ashtu edhe nëpër të gjitha rrugët lokale të territorit të Komunës së Lipjanit.

Me qëllim të sigurisë në trafik janë ndërtuar trotuare dhe rrjete të ndiçimit publik. Disa projekte të tilla janë edhe tani në proces zbatimi.

Me numrin e autobusëve në qarkullim dhe të “Taxi-ve”, si dhe me projektet e realizuara është rritur dukshëm cilësia e shërbimeve të transportit të udhëtarëve dhe siguria për të gjithë pjesëmarrësit në trafik.

### **13. PËRQINDJA E REALIZIMIT TË INVESTIMEVE KAPITALE PUBLIKE DHE PUBLIKO PRIVATE TË REALIZUARA NË PERIUDHËN E CAKTUAR NË KUADËR TË INFRASTRUKTURËS DHE SHËRBIMEVE PUBLIKE**

Përqindja e realizimit të investimeve kapitale publike të realizuara në infrastrukturë dhe shërbime publike për periudhen raportuese është:

Për periudhen korrik – dhjetor 2023 janë shpenzuar 65.78% të buxhetit të ndarë në kategorinë ekonomike “investime kapitale” ose e shprehur në vlerë monetare 5,798,991.73€

Për periudhen janar – qershor 2024 janë shpenzuar 46.37% të buxhetit të ndarë në kategorinë ekonomike “investime kapitale” të buxhetit të planifikuar ose shprehur në vlerë monetare 2,964,957.21€.

Për periudhen raportuese nuk ka pasur investime publiko private përmes formave të caktuara të partneritetit.

Sfidë themelore në periudhen raportuese për realizimin e projekteve kapitale ishte ngecja e shkaktuar për shkak të vonesave të koniderueshme në kthimin e përgjigjeve nga Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik në shqyrtimin e ankesave të parashtruara nga operatorët ekonomik. Sfidë tjetër ishte procesi i shpronësimit të disa pronave për realizimin e disa projekteve me interes të përgjithshëm publik.



#### 14. SHKALLA E INVESTIMEVE TË MËDHA TË PLANIFIKUARA

Ndarja buxhetore për vitin 2024 për Komunën e Lipjanit është 23,942,941.00€, kurse vetëm për investime kapitale 5,549,543.00€.

Në kuadër të investimeve më të mëdha të planifikuara për vitin 2024 përfshihen:

Fillimi i ndërtimit të parkut qendror të qytetit dhe parkingut nëntokësor 420,000.00;  
Vazhdimi i ndërtimit të parkut qendror dhe parkingut nëntokësor, Kontratë tri vjeçare 2,150,000.00;  
Vazhdimi i ndërtimit të sheshit të qytetit dhe nënkalimit rrugor;  
Vazhdimi i ndërtimit të Qendres Urgjente/Qendres Kryesore të Mjekësisë Familjare në Lipjan 310,000.00;  
Fillimi i ndërtimit të Qendres multifunkionale në qytetin e Lipjanit 390,000.00;  
Hapja dhe ndërtimi i rrugëve të reja në qytetin e Lipjanit 731,438;  
Renovimi eficient i tetë shkollave 240,000.00;  
Rregullimi i fushave sportive në Magure dhe Dobrajë të Madhe 350,000.00.

#### 15. TRAFIKU RRUGOR DHE PROJEKTET E REALIZUARA NË INFRASTRUKTURË PUBLIKE

Në kuadër të projekteve të realizuara në kuadër të trafikut rrugor dhe të infrastrukturës publike për periudhën raportuese përfshihen:

Tabela 2:

Nr.	Projekti	Statusi
1.	Ndërtimi i shtratit të lumit në Smallushë	Përfunduar
2.	Vazhdimi i ndërtimit të shtratit të lumit në Gadime	Proces
3.	Ndërtimi i shtratit të lumit në Glligovc	Përfunduar
4.	Rikonstruimi i rrugëve në Ribar të Madh (rr.Vehbi Kozhani e Beqir Duriqi)	Përfunduar
5.	Ndërtimi i shtigjeve të ecjes në Slllovi	Përfunduar
6.	Ndërtimi i shtigjeve të ecjes në Gadime faza e II-të	Përfunduar
7.	Ndërtimi i Rrugës në Bujan deri te rruga për Kraishtë	Përfunduar
8.	Rregullimi i shtratit të Lumit "Janjevka" në lagjen e Konjuhut në Lipjan	Përfunduar
9.	Ndërtimi i palestres sportive në Glligovc	Përfunduar
10.	Ndërtimi i palestres sportive në Lipjan	Përfunduar
11.	Ndërtimi i fushës së hapur sportive në Rubovc	Përfunduar
12.	Ndërrimi i kabinave të leximit në bibliotekën e qytetit dhe kabinave (mobileve) për vendosjen e lendëve në arkivë	Përfunduar
13.	Vazhdimi i ndërtimit të parkut qendror në Lipjan, parkingut nëntokësor, sheshit dhe nënkalimit	Proces
14.	Ndërtimi i Këndeve të lojrave për fëmijë në Lipjan, Slllovi dhe Gadime.	Përfunduar



15.	Renovimet e shkollave paralele të ndara në (Jeta e Re, Konjuh, Vërshevc, Resinovic, Lluga, Gadime e Ulët, Vrellë e Goleshit, Krojmir, Mirenë, Zllakuqan -Faza II 52165	Përfunduar
16.	Ndërtimi i parqeve dhe lojrave për fëmijë në shkollat fillore në fshatrat: Dobrajë e Madhe, Kraishtë, Rubovic, Banullë, Babush i Muhaxherëve, Llugaxhi, Smallushë, Shalë, Krojmir, Topliçan, Baicë, Poturovc, Medvec, Magure, Bujan, Gllugovic dhe Lipjan - faza II-të.	Përfunduar
17.	Asfaltimi i rrugës transit lagjësja e Konjuhut deri te Rruga regjionale Lipjan- Janjevë faza II-të.	Përfunduar
18.	Ndërtimi i shtratit të lumit në fshatin Smallushë faza II-të	Në proces
19.	Ndërtimi i qerdhes në Rufc të Ri Faza II-të	Përfunduar
20.	Rikonstruimi i rruges "Fehmi Agani" në Lipjan	Proces
21.	Ndërtimi i shtratit të lumit dhe asfaltimi i rrugës së Lumit në fshatin Gadime e Ulët	Përfunduar
22.	Prrockat (lumejtë) në Lipjan	Përfunduar
23.	Zbatimi i masave efikente në objektin Qendra në Lipjan	Përfunduar
24.	Ndërtimi i rrugicave në lagjet e fshatit Krojmir, Kraishtë dhe Zllakuqan faza e II-të	Në proces
25.	Rregullimi i infrastrukturës në Janjevë	Përfunduar
26.	Asfaltimi i rrugicave në lagjet e fshatrave Shalë, Resinovic, Qylage, Magure, Vershevc, Baice, Ribar i Madh, Bujari faza e IV-te (projekt I ri)	Në proces
27.	Rikonstruimi i rrjetit të kanalizimit në Akllap (Projekt I ri)	Në proces
28.	Renovimi i AMF në Babush	Përfunduar
29.	Ndërtimi i rrugës "Gryka e shpëtimit" në Krojmir	Në proces
30.	Rregullimi i shtratit të lumit në fshatin Medvec	Në proces
31.	Rregullimi i infrastrukturës rreth burimit të ujit në Medvec	Në proces

## 16. PROJEKTET E REALIZUARA NË KUADËR TË SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Në kuadër të projekteve të realizuara në kuadër të shëndetësisë dhe mirëqenies sociale për periudhën raportuese përfshihen:

**Tabela 3:**

Nr.	Projekti	Statusi
1	Ndërtimi i Qendres Urgjente në Qytetin e Lipjanit	Në proces
2	Renovimi i QMF Gadime, bashkëfinancim me AQH	Përfunduar
3	Renovimi i QMF në Janjevë	Përfunduar
4	Rregullimi i Infrastrukturës së jashtme në QMF Gadime, financuar nga AQH	Përfunduar
5	Furnizimi i QKMF-së me 13 klima.	Përfunduar
6	Renovimi dhe shtruarja me Epoksit e Katit të I-rë të QKMF-së, Financuar nga AQH	Përfunduar
7	Furnizimi i QKMF-se me 2 fshesa të rënda industriale dhe i QMF-së në Gadime me një fshesë industriale, financuar nga AQH	Përfunduar



8	Rregullimi i këshillimores së re në QKMF, financuar nga AQH	Përfunduar
9	Blerja e dy autokombi për bartjen e pacienteve me hemodializë	Përfunduar
10	Blerja e aparatit digjital të rëntgenit dhe pajisjeve mbrojtëse për staf	Përfunduar
11	Pranimi i 9 frigoriferëve për vaksinim për QKMF nga UNICEF	Përfunduar
12	Renovimi i toaleteve në QPS dhe furnizimi dhe montimi i ashensorit në QPS, donacion i Zyres së BE-së	Përfunduar
13	Pranimi i nje veture donacion për QPS nga UNICEF dhe RaiffeisenB.	Përfunduar

### 16.1. Synimet themelore për periudhen vijuese:

Synim kryesor strategjik i DSHPS-së është ruajtja e shëndetit të popullatës, përmes promovimit të mënyrave të shëndetshme të jetesës, ofrimit të shërbimeve shëndetësore të sigurta dhe cilësore, me qasje të lehtë dhe të barabart për të gjithë qytetarët e Komunës së Lipjanit.

Synim specifik për periudhen e ardhshme tre vjeçare është përfundimi i ndërtimit të Qendres Kryesore të Mjekësisë Familjare në Lipjan.

## 17. PROJEKTET E REALIZUARA NË KUADËR TË ARSIMIT

Në fushën e arsimit në vazhdimësi janë realizuar projekte të rëndësishme dhe sipas planifikimit me HZK, duke përfshirë: ndërtimin e objekteve të arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm si dhe të infrastrukturës përcjellëse. Po ashtu janë realizuar projekte për rritjen e cilësisë në arsim, duke përfshirë furnizimin e kabineteve dhe të sigurisë në shkolla.

Në kuadër të projekteve të realizuara në kuadër të Arsimit për periudhen raportuese përfshihen:

**Tabela 4:**

Titulli i projektit	Përfundimi	Vlera e projektit
Ndërtimi i Çerdhës në Shalë	10 Shtator 2023	257,996.22€
Ndërtimi i Çerdhës në Rufc	15 Nëntor 2023	478,800.56€
Ndërtimi i shkollës në Ribar të Madh	11 Nëntor 2023	441,389.46€
Rrënimi i shkollës së vjetër në Resinovec dhe shkolla e vjetër Adem Gllavica	Përfunduar 2024	13,918.73€
Rregullimi i kulmit në shkollën në Babush i Muhaxherëve	Nëntor 2023	33,181.80 €
Ndërtimi i sallës sportive në Shfmu "Ismail Luma" në Lipjan	2023 Proces	164,210,00€
Ndërtimi i sallës sportive në Shfmu "Emin Duraku" në Banullë	Përfunduar	255,000.00€

Ndërtimi i objekteve të reja shkollore, qerdheve për fëmijë, sallave sportive, parqeve dhe këndeve të lojrave është duke u zhvilluar në kuadër të kufinjëve të përcaktuar me hartën për shfrytëzimin e



tokës, prandaj ndërtimi i tyre është zhvilluar në kuadër të kufinjëve të përcaktuar dhe nuk kanë implikime të veçanta hapësinore.

### *17.1 Synimet themelore për periudhën vijuese:*

Hartimi i Planit Zhvillimor Komunal për Arsimin Parauniversitar.

## **18. PROJEKTET E REALIZUARA NË KUADËR TË ZHVILLIMIT EKONOMIK**

Në kuadër të zhvillimit ekonomik<sup>14</sup> janë realizuar një mori projektesh nga fusha të ndryshme të ekonomisë. Projekte të caktuara janë realizuar në krijimin e kushteve infrastrukturore për zhvillim ekonomik, duke përfshirë rehabilitimin e shtretërve të lumenjëve, ndërtimin e rrugëve të kategorisë së IV me qëllim të përmirësimit të kushteve në sektorin e bujqësisë, pastaj në ngritjen e kapaciteteve profesionale njerëzore në degë të ndryshme të bujqësisë, si dhe në zhvillimin e kapaciteteve të tjera teknike. Po ashtu janë realizuar projekte të ndryshme për përkrahjen materiale të kategorive të ndryshme në fushën e prodhimit, plasimit të produkteve vendore dhe promovimit të tyre.

Edhe në periudhën e dytë të vitit 2023 është vazhduar me zhvillimet në kuadër të zones së licencuar ekonomike në Qylagë. Në vitin paraprak dhe fillim të këtij viti është zbatuar Memorandumi në mes të Komunës së Lipjanit dhe MINT/KIESA në shumë totale prej 478 307.51 € nga shuma e terësishme prej 688 835.12 € në kuadër të projektit për zhvillimin e infrastruktures për parkun industrial në Qylagë - faza e IV-të.

Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim ka realizuar disa projekte në fushën e ndërmarrësisë me vlerë totale 26,400.00€, duke përfshirë fushën e mbështetjes së bizneseve me informata si dhe bashkëpunime me investitorë të ndryshëm në fushën e zhvillimit ekonomik.

## **19. SHKALLA E PRODHIMIT**

Në listën e regjistrimit të bizneseve në kuadër të sistemit që e administrojnë Dega e Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës në komunën e Lipjanit deri me datën 05.03.2024 janë të regjistruara 6341 biznese të llojeve të ndryshme. Prej tyre aktive janë 2844 biznese, pasive 2775, të çregjistruara 772 biznese.

Për nga lloji (forma) i organizimit, këto biznese në numër të konisueshëm janë individuale, kurse një pjesë tjetër janë të organizuara si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

Për nga lloji i aktiviteteve që i ushtrojnë bizneset, dominojnë aktivitetet tregtare, pastaj ato nga fusha e ndërtimit, transportit, aktiviteteve shërbyese etj.

Bizneset që ushtrojnë veprimtari prodhuese numerikisht janë më pak krahasuar me bizneset që ushtrojnë veprimtari të tjera. Lidhur me shkallën e prodhimit të këtyre bizneseve nuk posedojmë informata përkatëse.

<sup>14</sup> Në kuadër të zhvillimit ekonomik përfshihet edhe bujqësia me turizimin.



## 20. ANKETIMET E FAMILJEVE BUJQËSORE

Komuna e Lipjanit karakterizohet si vend i zhvilluar bujqësor dhe me potenciale të mëtejme të zhvillimit në fushat e ndryshme të bujqësisë.

Drejtorati i Bujqësisë nuk ka bërë anketim të ekonomive bujqësore në terren, mirëpo posedon një program të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në të cilin janë të regjistruar të gjithë fermerët e Komunës së Lipjanit, ku secili në mënyrë individuale ka deklaruar të dhënat për ekonominë bujqësore.

Komuna e Lipjanit ka një sipërfaqe bujqësore prej 25,867 ha, ku sipas Agjencionit të Statistikave të Kosovës në Komunën e Lipjanit janë 18,547.41 ha sipërfaqe e shfrytëzuar e tokës bujqësore, ndërsa sipas të dhënave të nxjerura nga Drejtorati i Bujqësisë nga aplikimi i fermërve për subvencione për vitin 2023 del që të mbjellurat vjeshtore dhe pranverore shkojnë në rreth 9100 ha.

Këto të dhëna ofrojnë një burim të rëndësishëm të informatave mbi gjendjen e tanishme të bujqësisë në Komunën e Lipjanit për vitin 2023/24. Në tabelën më poshtë janë të paraqitura rezultatet në formë përmbledhëse për shfrytëzimin e tokës bujqësore, kulturat bujqësore pemtarinë, blegtorinë, bletarinë të marrura nga databaza e programit e LPIS dhe e FR gjatë aplikimit për pagesa direkte për vitin 2023/24<sup>15</sup>.

Të dhënat janë të deklaruara nga vete fermerët për sipërfaqet e mbjellura me kulturat bujqësore, për numrin e krerëve dhe numrin e shoqërive të bletëve.

Në funksion të zhvillimit të bujqësisë, për periudhen raportuese komuna e Lipjanit ka realizuar disa projekte për furnizimin e ekonomive familjare me pajisje dhe mekanizëm bujqësor, duke përfshirë ndarjen e serave, frezave, kositëseve, etj.

**Tabela 5:**

Kulturat	Sipërfaqja në Ha / Numri për copë
Grurë	4008.77
Misër	4350.30
Elb	23.10
Tërshërë	71.22
Kunguj	95.35
Specat	34.62
Patate	150.69
Domate	0.98
Hudhër	0.35
Qepë	79.82
Lakër	6.52
Fasule	196.36
Shalqinjë	15.72

<sup>15</sup> Në këto të dhëna nuk përfshihen fermerët të cilët posedojn sipërfaqe me grurë < 1 ha, misër elb dhe tërshër < 1 ha, perime < 0.50 ha, pemë drufutrore < 0.50 ha, pemë të imta < 0.20 ha, lopë qumështore nën 5 copa, dele e dhi nën 30 copa, dhe shoqësi bletësh nën 30 copa.

Kunguj misiri	17.06
Perime në serrë	6.86
Thekër	0.50
Luledielli	0.95
Lulelakër	0.88
Pjepër	15.45
Mollë	47.10
Dardhë	2.40
Lajthi	14.65
Arra	30.57
Kumbulla	24.51
Aroni	0.30
Dredhëz	3.10
Mjedër	2.71
Qershi	2.28
Kajsi	1.52
Vishnje	0.48
Vreshta	4.80
Lopë	1534
Viça	202
Dele	2896
Dhi	593
Shoqëri bletësh	5435

Në periudhen e I-rë të vitit 2024 ka filluar edhe zhavorimi i rrugëve rurale me qëllim të krijimit të kushteve sa më të mira të shfrytëzimit të tokës bujqësore. Punimet kanë filluar me dt.28.05.2024 dhe janë duke vazhduar sipas kontratës për vitin 2024. Vlera e kontratës është 260 000 € për vitin 2014 dhe 260, 000 € për vitin 2025.

Që nga fillimi i punimeve deri me tani janë zhavoruar rreth L=7000 m gjatësi ku gjerësia e rrugëve është nga 3 deri në 4. Punimet janë duke u vazhduar dhe planifikojmë që këtë vit të realizohen deri në 10 km rrugë fushore, ndërsa vitin tjetër pritet të zhavorohen mbi 10 km.

Rrugët e zhavoruara deri më tash janë kryer në 9 vendbanime rurale.

## **21. VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM PËR TË ARRITURAT SIPAS FUSHAVE SEKTORIALE**

Për çështjet urbane teknike të zbatimit të HZK, vlerësimin e kemi dhënë në pikën 8 të këtij Raporti. Të dhënat e ofruara tregojnë për një nivel pak më të lartë të zbatueshmërisë së HZK në fushën e ndërtimeve krahasuar me vitin paraprak raportues.

Për çështjet e fushave të tjera sektoriale, vlerësojmë se përfshirja e projekteve për realizim është në përputhje me Planin e Veprimit të përcaktuar me Shtojcën 1 të HZK.



Në krahasimin e të dhënave të prezantuara në këtë Raport dhe të dhënave të përcaktuara me Planin e Veprimit, vërehet se projektet dhe arritjet në kuadër të aktiviteteve tjera janë realizuar në nivelin e pritjeve dhe mundësive buxhetore sipas periudhave të caktuara të viteve përkatëse.

Për një vlerësim pak më specifik të këtyre fushave, duhet pasur parasysh periudhen raportuese që përfshinë dy gjysmë vite, prandaj matjet dhe krahasimi i rezultateve është i ndërlidhur drejtpërdrejt me vitet buxhetore dhe kjo rrethanë e bënë mjaft kompleks procesin e vlerësimit për shkak të shkëputjes së këtyre periudhave.

### **III. PËRFUNDIMTARE**

#### **22. RISHQYRTIMI I PËRMBAJTJES DHE PËRMASAVE TË NDRYSHIM PLOTËSIMEVE, PËRJASHTIMEVE DHE BONUSEVE TË ZONIMIT**

Autoriteti përgjegjës për planifikim hapësinor në bashkëpunim me organet kompetente të komunës së Lipjanit, që në vitin e parë të zbatimit të HZK-së ka vlerësuar se në këtë dokument duhet bërë disa ndërhyrje në formë të ndryshimeve dhe plotësimeve, mirëpo lidhur me këte nuk morëm pëlqimin nga autoriteti përgjegjës qendror.

Vlerësojmë se ndërhyrjet e mundshme përmes formave tjera si bonuseve, përjashtimeve të veçanta etj. nuk paraqesin zgjidhje në parim dhe nuk janë kompatible me përmbajtjen e disa çështjeve të HZK që realisht konsiderohen si pengesa të pa kalueshme në zbatimin më efikas të HZK-së.

Aktualisht komuna e Lipjanit e ka para përfundimit hartimin e Planit Zhvillimor Komunal. Mirëpo ky process tani më është i pezulluar për shkak të rrethanave të njohura edhe për Kuvendin e Komunës së Lipjanit.

#### **23. PËRFUNDIM**

Vlerësojmë se përmes këtij Raporti, kemi ofruar informacione të mjaftushme lidhur me monitorimin e nivelit të zbatimit të HZK të Komunës për periudhen e lartshënuar.

Megjithate, fokusi i trajtimit të implikimeve hapësinore të zhvillimeve sipas HZK është një aspekt kompleks për trajtim dhe ka hapësirë edhe për informacione më të detajuara për të cilat duhen analiza dhe vlerësime më të thella profesionale.

Ndërtimet me leje zhvillohen kryesisht në kuadër të kufinjëve të përcaktuar me hartën për shfrytëzimin e tokës.

Me të dhënat e ofruara, sidomos me zhvillimet në fushen e ndërtimeve dhe zhvillimet në infrastrukturen publike, vlerësojmë se kemi pasqyruar gjendjen aktuale në aspektet themelore të niveleve të zbatueshmërisë së Hartës Zonale të Komunës në vitin e tretë pas hyrjes në fuqi të saj.

Gusht 2024

DREJTORATI PËR PLANIFIKIM, URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT